

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Bazat e Auditimit të
Brendshëm
Internal Audit Basics**

B2

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 07/10/2023

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Kush është përgjegjës për vlerësimin në mënyrë periodike të faktit se veprimtaritë, qëllimi, autoriteti dhe përgjegjësitë e auditimit të brendshëm, ashtu siç përcaktohen në statutin e auditimit të brendshëm, vazhdojnë të jenë të përshtatshme dhe vazhdojnë t'i mundësojnë aktiviteve të kontrollit të brendshëm të përmbushin objektivat e tyre?
 - a) **Shefi Ekzekutiv për Auditime**
 - b) Komiteti i auditimit
 - c) Drejtori Ekzekutiv
 - d) Bordi i drejtorëve

2. Pavarësia në shkallë organizate, si funksion, thuhet se është arritur në mënyrë efektive kur:
 - a) **Shefi Ekzekutiv për Auditime i raporton vetë bordit.**
 - b) Drejtoriy Ekzekutiv i raporton bordit për auditimet.
 - c) Shefi Ekzekutiv për Auditime i raporton Drejtori Ekzekutiv për auditimet.
 - d) Shefi Ekzekutiv për Auditime i raporton Komitetit të auditimit.

3. Raportimi i Shefit Ekzekutiv për Auditime si administratë zakonisht përfshin të gjitha informacionet si në vijim përveç njëres. Cili opsion në vijim NUK përfshihet në raportimin si administratë?
 - a) Buxhetimin dhe kontabilitetin menaxherial.
 - b) Administrimin e burimeve njerëzore, përfshirë këtu vlerësimet e personelit dhe kompensimet përkatëse.
 - c) **Statutin e përgjithshëm të veprimtarive të auditimit të brendshëm**
 - d) Administrimin e politikave dhe procedurave të veprimtarive të auditimit të brendshëm.

4. Cila nga kontrollet e mëposhtëm mund të jetë pjesë e kontrolleve të tjerë?
 - a) **Kontrollet në nivel entiteti.**
 - b) Kontrollet manuale.
 - c) Kontrolle plotësisht të automatizuara.
 - d) Kontrolle pjesërisht të automatizuara.

5. Fushëveprimi i punës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një programi të siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë përfshin cilin nga proceset e mëposhtme?
 - I. Mbikëqyrja
 - II. Vlerësimi i brendshëm
 - III. Monitorimi i vazhdueshëm
 - IV. Vlerësimi i jashtëm
 - a) Vetëm I
 - b) I dhe II
 - c) I, II dhe III
 - d) **Të gjitha**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

6. Cila nga opsionet e mëposhtme është unike për vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve të auditimit të brendshëm në krahasim me vlerësimin e brendshëm?
 - a) Gjetjet
 - b) Përfundimet
 - c) Rekomandimet
 - d) Opinioni i përgjithshëm**

7. Cila nga opsionet e mëposhtmet mund të përdoret nga një rishikues i jashtëm i pavarur kur përcaktohet fusha e vlerësimit të jashtëm të veprimtarisë së një auditimi të brendshëm?
 - a) Përqindja e planit të auditimit të përfunduar në një vit nga auditimi i brendshëm.
 - b) Numri i gjetjeve të raportuara në një vit nga auditimi i brendshëm.
 - c) Përqindja e programit të siguri dhënies dhe përmirësimit të cilësisë i zbatuar nga auditimi i brendshëm.**
 - d) Numri i rekomandimeve të auditimit të pranuar në një vit nga të audituarit.

8. Statuti i auditimit të brendshëm normalisht kërkon që aktiviteti i auditimit të brendshëm të përqendrohet në fushat që përbëhen nga cila nga sa më poshtë?
 - a) Rrezik i lartë i qenësishëm dhe rrezik i lartë residual.**
 - b) Rrezik i lartë i auditimit dhe rrezik i lartë aktual.
 - c) Rrezik i ulët i qenësishëm dhe rrezik i ulët i auditimit.
 - d) Rrezik i ulët i qenësishëm dhe rrezik i lartë i mbetur.

9. Kërkimi i një procesi të "pranimit të projektit" kur auditorët e brendshëm janë të përfshirë në projektin e një njësie biznesi, mund të zbusë cilën nga rreziqet e mëposhtmet?
 - a) Rrezikun e biznesit.
 - b) Rrezikun e dështimit të auditimit
 - c) Rrezikun e sigurisë së rreme.**
 - d) Rrezikun e reputacionit të keq

10. Kur vlerësohet pavarësia e një departamenti të auditimit të brendshëm, një ekip i vlerësimit të cilësisë konsideron disa faktorë. Cili nga faktorët e mëposhtëm ka më së paku ndikim kur gjykohet pavarësia e një departamenti të auditimit të brendshëm?
 - a) Kriteret e përdorura në përcaktimin e detyrave të auditorëve.
 - b) Shtrirja e trajnimit të auditorit në aftësitë e komunikimit.**
 - c) Marrëdhënia midis letrave të punës së auditimit dhe raportit të auditimit.
 - d) Gjykimet e drejta dhe të paanshme të auditimit.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

11. Si auditor i brendshëm i një kompani shumëkombëshe e cila merret me prodhimin e kimikateve, ju jeni caktuar të kryeni një auditim operacional në një fabrikë lokale. Ky impiant është i ngjashëm në moshë, përmasa dhe ndërtim me dy impiante të tjera të kompanisë që janë përmendur kohët e fundit për shkarkimin e mbetjeve të rrezikshme. Përveç kësaj, ju jeni të vetëdijshëm se kimikatet e prodhuara në fabrikë çlirojnë nënprodukte toksike. Identifikoni përgjegjësinë tuaj për zbulimin e një problemi të shkarkimit të mbetjeve të rrezikshme.
- Ju nuk keni asnjë përgjegjësi; është shqetësim i agjencisë përkatëse qeveritare.
 - Ju jeni përgjegjës për të siguruar përputhjen me politikën dhe procedurat e kompanisë.
 - Auditimet operative nuk kërkojnë një përcaktim të pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret.
 - Standardet ju kërkojnë të përcaktoni pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret.**
12. Cili nga veprimet e mëposhtme nga një auditor do të shkelte Kodin e Etikës?
- Auditimi i një aktiviteti të menaxhuar nga bashkëshorti/ja i auditorit.**
 - Një investim financiar material në kompani.
 - Përdorimi i makinës së kompanisë.
 - Një interes i konsiderueshëm pronësie në një biznes jo të lidhur.
13. Një Auditor i Brendshëm i Certifikuar rezulton se ka kryer shkelje të Kodit të Etikës. Shkelja nuk është aq e rëndë sa të garantojë masën maksimale disiplinore. Rezultati më i mundshëm është se Auditor i Brendshëm i Certifikuar do të:
- Kërkohej të marrë ndjekë deri në 24 orë shtesë të edukimit të vazhdueshëm profesional.
 - Të humbasë përgjithmonë certifikimin si Auditor i Brendshëm, përveç nëse rikthimi i mëvonshëm i certifikimit miratohet nga bordi i drejtorëve të shoqatës.
 - Ndalohet përfshirja në praktikën e auditimit të brendshëm për një periudhë jo më të gjatë se 60 ditë.
 - Merr nga bordi i drejtorëve të shoqatës një vërejtje me shkrim që përshkruan pasojat për veprimet e ngjashme të përsëritura.**
14. Auditorët e brendshëm duhet të jenë të kujdesshëm në marrëdhëniet e tyre me persona dhe organizata të jashtme nga punëdhënësit e tyre. Cili nga aktivitetet e mëposhtme NUK do të ndikonte negativisht në sjelljen etike të auditorëve të brendshëm?
- Pranimi i kompensimit nga organizatat profesionale për punë konsulente.**
 - Të shërbyerit si konsulentë për kompanitë konkurrenente.
 - Të shërbyerit si konsulentë për furnitorët.
 - Diskutimi i planeve apo rezultateve të auditimit me palët e jashtme.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

15. Cili nga veprimet e mëposhtme mund të interpretohet si shkelje e Kodit të Etikës?
- a) **Dështimi për t'i raportuar menaxhmentit informacione që do të ishin materiale në gjykimin e menaxhmentit.**
 - b) Dhënia e një opinioni mbi pasqyrat e brendshme financiare.
 - c) Dorëzimi i një çështjeje në departamentin e sigurisë kur auditori dyshon për mashtrim, por nuk ka dëshmi.
 - d) Përfshirja e një problemi të kontrollit të brendshëm në raport, kur ai është korrigjuar para përfundimit të auditimit.
16. Cila nga veprimet në vijim do të ishte e lejueshme sipas Kodit të Etikës?
- a) **Zbulimi i informacionit konfidencial, të lidhur me auditimin, që është potencialisht i dëmshëm për organizatën në një gjykatë në përgjigje të një thirrjeje**
 - b) Përdorimi i informacionit të lidhur me auditimin në një vendim për të blerë aksione të emetuara nga kompania pundhënëse.
 - c) Pranimi i një dhurate të papritur nga një punonjës të cilin e keni lavdëruar në një raport të fundit të auditimit.
 - d) Mos raportimi i një gjetjeve të rëndësishme në lidhje me një aktivitet të jashtë-ligjshëm tek komiteti i auditimit sepse menaxhmenti ka premtuar që do ta trajtojë këtë çështje.
17. Një Auditor i Brendshëm i Certifikuar i cili kryen auditime financiare, operationale dhe të sistemeve të informacionit po përballlet me një dilemë etike. Gjatë një auditimi, ajo zbuloi disa aktivitete të jashtë-ligjshme të kryera nga menaxhmenti i lartë i firmës. Çfarë duhet të bëjë auditori tani?
- a) Veproni në pajtueshmëri me Kodin e Etikës dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
 - b) Veproni në pajtueshmëri me Kodin e Etikës dhe Standardet Ndërkombëtare Auditimit.
 - c) **Veproni në pajtueshmëri me Kodin e Etikës dhe Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm**
 - d) Veproni në pajtueshmëri me Kodin e Etikës dhe Standardet ISO.
18. Një shoqatë kontabiliteti krijoi një kod etike për të gjithë anëtarët. Identifikoni qëllimin kryesor të shoqatës për krijimin e kodit të etikës.
- a) **Të përcaktojë kriteret për sjelljen profesionale për të ruajtur standardet e kompetencës, moralit, ndershmërisë dhe dinjitetit brenda shoqatës.**
 - b) Të vendosë standarde që duhen ndjekur për praktikë efektive kontabël.
 - c) Të sigurojë një kuadër brenda të cilit politikat kontabël mund të zhvillohen dhe zbatohen në mënyrë efektive.
 - d) Për të përshkruar kriteret që mund të përdoren në kryerjen e intervistave të kontabilistëve të rinj potencialë.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

19. Cila nga situatat e mëposhtme ka më së shumti mundësi të konsiderohet si shkelje e Kodit të Etikës të IIA-s dhe rrjedhimisht e standardeve?
- a) **Si shef ekzekutiv i auditimit, ju jeni në dilem se si të zgjidhni një mosmarrëveshje të veçantë midis jush dhe menaxhmentit të të audituarit në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet në një fushë shumë të ndjeshme auditimi. Të pasigurt se çfarë të bëni, ju diskutoni detajet e gjetjes dhe rekomandimin tuaj të propozuar me një koleg i cili është gjithashtu auditor i brendshëm me të cilin njihni nga puna juaj e kaluar në shoqatën e auditorëve.**
 - b) Pas hulumtimit dhe zhvillimit të planit të propozuar vjetor të auditimit, statuti i auditimit të kompanisë suaj kërkon që, si shef ekzekutiv i auditimit, t'ia paraqisni planin komitetit të auditimit për miratimin dhe sugjerimet e tij.
 - c) Menaxheri juaj i auditimit sapo ka hequr gjetjen dhe rekomandimin tuaj më të rëndësishëm nga raporti juaj i auditimit. Duke qenë se ju jeni auditori përgjegjës në atë auditim, ju keni shprehur kundërshtimin tuaj ndaj largimit të gjetjes dhe keni shpjeguar se e dini se ekziston gjendja e raportuar. Edhe pse jeni dakord që, teknikisht, auditimit i mungojnë provat e mjaftueshme për të mbështetur të gjeturat, menaxhmenti nuk mund ta shpjegojë gjendjen dhe gjetja e auditimit tuaj është i vetmi përfundim i arsyeshëm.
 - d) Për shkak se departamenti tuaj i mungojnë aftësitë dhe njohuritë në një fushë specialiteti, shefi ekzekutiv i auditimit ka angazhuar shërbimet e një konsulenti ekspert. Si menaxher auditimi, ju është kërkuar të rishikoni qasjen e ekspertit ndaj detyrës. Ju keni njohuri për fushën në shqyrtim, por hezitoni të pranoni detyrën sepse ju mungon ekspertiza për të gjykuar vlefshmërinë e përfundimit të ekspertit.
20. Një kompani kohët e fundit ka vendosur një ish-menaxher operativ në pozicionin e shefit ekzekutiv të auditimit. Shefi i ri i auditimit nuk është anëtar në shoqatë profesionale dhe nuk është Auditor i Brendshëm i Certifikuar. Tash e tutje, departamenti i auditimit të brendshëm do të drejtohet rreptësisht sipas standardeve të Shefit të auditimit, dhe jo sipas Standardeve Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm. Të katër auditorët e stafit janë anëtarë të shoqatës profesionale, por ata nuk janë Auditor të Brendshëm të Certifikuar. Sipas Kodit të Etikës, cila është mënyra më e mirë e veprimit për auditorët e stafit?
- a) Kodi i Etikës nuk zbatohet sepse auditorët nuk janë Auditor të Brendshëm të Certifikuar.
 - b) **Auditorët duhet të adoptojnë mjete të përshtatshme për të qenë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm.**
 - c) Auditorët duhet të shfaqin besnikëri ndaj organizatës dhe të injorojnë Standardet IIA.
 - d) Auditorët duhet të japin dorëheqjen nga puna për të shmangur aktivitetet e jashtë-ligjshme.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

21. Kush ka përgjegjësinë kryesore në përcaktimin e tonit në krye të një ndërmarrjeje i cili ndikon mbi integritetin, etikën dhe faktorë të tjerë të një mjedisi pozitiv të kontrollit?
- Zyrtari Kryesor financiar
 - Shefi ekzekutiv i auditimit
 - Krye shefi Ekzekutiv**
 - Bordi i Drejtorëve
22. Politikat dhe procedurat e një organizate janë pjesë e sistemit të saj të përgjithshëm të kontrolleve të brendshme. Funkzioni i kontrollit i kryer nga politikat dhe procedurat është:
- Kontrolli parandalues (feed-forward)**
 - Kontrolli i zbatimit.
 - Kontrolli reagues (feedback)
 - Kontrolli i aplikimit.
23. Refuzimi i modifikimeve të paautorizuara në sistemet e aplikimit mund të arrihet përmes përdorimit të:
- Kontrolleve të zbatimit**
 - Kontrollit një - nga - një
 - Kontrolleve të programuara
 - Kontrolleve të grupeve
24. Për t'u siguruar që mallrat e marra janë të njëjta me ato të faturara në faturën e blerjes, një sistem i kompjuterizuar duhet të:
- Përputh fushat e zgjedhura të faturës së blerjes me mallrat e marra.**
 - Mbaj totalin e kontrollit të vlerës së inventarit.
 - Llogarit totalin e grupeve për secilin hyrje.
 - Përdor shifrat e kontrollit në numrat e llogarisë.
25. Cili nga kontrollet e mëposhtëm do të ishte më efikas në zvogëlimin e gabimeve të zakonshme të futjes së të dhënave?
- Verifikimi i kreut dhe i fundit..
 - Set i kontrolleve të editimeve të dizajnuara mirë.**
 - Balancimi dhe rekonsilimi
 - Totalet e grupeve.
26. Cila nga opsionet e mëposhtme është e saktë lidhur me llojet e kontrolleve sipas dimensioneve të ndryshme kohore?
- Kontrollet parandaluese, Kontrollet zbuluese dhe Kontrollet korigjuese
 - Kontrollet paraprake, Kontrollet e ndërkohshme dhe Kontrollet pasuese**
 - Kontrollet e kombinuara dhe Kontrollet plotësuese
 - Kontrollet kompenzuese dhe Kontrollet kontradiktore

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

27. Anulimi i transaksioneve dhe Inkriptimi i të dhënave janë kontrolle:

- a) **Parandaluese**
- b) Zbuluese
- c) Korigjuese
- d) Zbuluese dhe Korigjuese

28. Kontrollat kompensuese janë të nevojshme kur kontrollat manuale janë të dobëta. Në rastin kur një kontroll i sistemit të aplikimit është i dobët një zgjidhje e mundshme do të ishte:

- a) **Kërkoni që kontrollet përkatëse të përgjithshëm të jenë të fortë**
- b) Kërkoni kontrolle të forta përkatëse të aplikimit
- c) Kërkoni kontrolle të forta të sigurisë për qasje logjike
- d) Kërkoni kontrolle të forta të sigurisë për qasje fizike, rishikime nga mbikëqyrësit, apo më shumë teste të pavarura.

29. Kujt i takon përgjegjësia përfundimtare për vënien në zbatim të kontrolleve që janë efektive për sa i takon kostove, si për sistemet manuale ashtu edhe për ato të automatizuara.

- a) Bordit të drejtorëve
- b) Drejtorit financiar
- c) Komitetit drejtues për teknologji informative
- d) **Menaxhmenti që është përgjegjës për operacionet**

30. Kur vlera e tregut të një kompanie (vlera e të gjitha aksioneve të shitura plus borxhi i kompanisë) është më e madhe se i gjithë kapitali i investuar në të nga aksionarët, mbajtësit e fletë - obligacioneve, dhe fitimet e mbajtura, kompania ka:

- a) **MVA pozitive**
- b) MVA negative
- c) EVA pozitive
- d) EVA negative

31. Vlera e shtuar ekonomike EVA është një teknikë e kontrollit financiar e cila prek pak a shumë të gjitha elementet që mund të realizojë një kompani për të shtuar vlerën e përfutur nga aktivitetet e saj. EVA mund të përcaktohet si:

- a) Vlera e të gjitha aksioneve të shitura plus borxhi i kompanisë
- b) **Vlera neto (pas tatimeve) e fitimit operativ të kompanisë minus koston e kapitalit të investuar në pasuritë e trupëzuara të kompanisë**
- c) Të ardhurat neto minus kthimin nga investimet
- d) Fitimi operativ kompanisë pjesëtuar për pasuritë minus detyrimet afatshkurta

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

32. Caktimi i autoritetit dhe përgjegjësive, si dhe Grupet e mbikëqyrjes janë përbërësit kryesor të cilit standard të kontrollit të brendshëm të COSO-s:
- Mjedisit të Kontrollit**
 - Vlerësimit të rrezikut
 - Aktiviteteve të kontrollit
 - Informimit dhe Komunikimit
33. Ndjeshmëria e një pohimi të menaxhmentit ndaj anomalive materiale, duke supozuar se nuk ka politika, struktura të kontrollit ose procedura të brendshme përkatëse është rrezik i:
- Vetvetishëm**
 - Kontrollit
 - Auditimit
 - Mbetur/ rezidual
34. Menaxhimi i rrezikut ndahet në dy kategori. Cila nga opsionet e mëposhtme paraqet kategoritë e sakta të ndarjes së menaxhimit të rrezikut:
- Vlerësimi i rrezikut dhe Eliminimi i rrezikut
 - Eliminimi i rrezikut dhe Financimi i rrezikut
 - Financimi i rrezikut dhe Monitorimi i rrezikut
 - Kontrolli i rrezikut dhe Financimit rrezikut**
35. Probabiliteti që një vlerësim i bazuar në një mostër të rastësishëm bie brenda një intervali të caktuar njihet si:
- Shkalla e gabimit.
 - Kufiri më i ulët i saktësisë.
 - Niveli i besueshmërisë.**
 - Gabim standard i mesatares.
36. Gama në të cilën një vlerësim i një karakteristike të popullsisë pritet të bjerë në një nivel të deklaruar besueshmërisë njihet si:
- Precizion.**
 - Masa e tendencës qendrore.
 - Devijimi standard.
 - Korniza e mostrimit
37. Cila nga sa vijon duhet të dihet për të vlerësuar rezultatet e një mostre të veçorive?
- Vlera e vlerësuar në dollarë e popullsisë.
 - Devijimi standard i vlerave të mostrës.
 - Madhësia e mostrës së zgjedhur.**
 - Faktori i korrigjimit të popullsisë së fundme.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

38. Një auditor i brendshëm i një banke dëshiron të përcaktojë nëse huatë që nuk janë financuar janë refuzuar duke përdorur kritere në përputhje me ato të përfshira në politikat e bankës. Një zyrtar kredie fillimisht përpunon të gjitha kërkesat për kredi. Ato që zyrtari i konsideron të përshtatshme për t'u financuar i përcillen komitetit të huadhënies për miratim. Procedura më efikase e auditimit për të adresuar këtë objektiv do të ishte:

- a) **Zgjidhni një mostër të veçorie të kredive të pa-financuara dhe rishikoni aplikimet për kredi dhe arsyet e refuzimit të tyre.**
- b) Zgjidhni një mostër të veçorive të kredive që janë financuar, shqyrtoni aplikacionet për kredi dhe përcaktoni nëse kreditë e financuara ishin në përputhje me politikat e bankës.
- c) Merrni një mostër të të gjitha aplikacioneve për kredi, rishikoni aplikacionet dhe gjurmoni ato në një kredi të financuar ose të refuzuar për të përcaktuar nëse të gjitha veprimet e ndërmarra ishin në përputhje me politikat e bankës.
- d) Merrni një mostër të kredive të paraqitura në komitetin e huadhënies për miratim dhe përcaktoni nëse veprimet e ndërmarra të komisionit ishin në përputhje me politikat e bankës.

39. Cila nga teknikat e mëposhtme të auditimit të sistemeve të informacionit përpunon të dhënat reale të transaksionit (ose një kopje të të dhënave reale) përmes programeve të testimit të zhvilluara nga auditori?

- a) Objektet e testeve të integruara (ITF)
- b) Gjurmimi.
- c) **Simulimi paralel**
- d) Krijimi i hartave

40. Për të përcaktuar nëse ka pasur ndonjë ndryshim të paautorizuar të programit që nga përditësimi i fundit i autorizuar i programit, teknika më e mirë e auditimit të teknologjisë së informacionit është që auditori të kryejë:

- a) **Krahasim të kodit të objektit**
- b) Rishikim të kodit
- c) Ekzekutimet e të dhënave të testimit
- d) Rishikim analitik

41. Në auditimin e një sistemi të inventarit të përhershëm në internet, një auditor zgjedhi disa transaksione të përditësimit të skedarëve për testim të detajuar. Teknika e auditimit që do të sigurojë një gjurmë kompjuterike të të gjithë hapave përkatës të përpunimit të aplikuar për një transaksion specifik përshkruhet si:

- a) Simulimi.
- b) Foto e çastit.
- c) Krahasimi i kodeve.
- d) **Etiketimi dhe gjurmimi.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

42. Cila nga pohimet e mëposhtme NUK është e vërtetë në lidhje me detyrat që një softueri i përgjithësuar i auditimit është në gjendje të kryejë?
- Ofron totale të artikujve të pazakontë.
 - Kontrollon për dublikime, informacione që mungojnë ose diapazon vlerash.
 - Përcakton se cilët elementë të të dhënave do të testohen dhe kriteret që do të përdoren.**
 - Verifikon totalët e llogaritjeve dhe analizat e prodhuara.
43. Arsyeja kryesore që auditorët hezitojnë të përdorin Objektet e testeve të integruara (ITF) është se ajo u kërkon atyre të:
- Largojë regjistrime specifike të skedarëve kryesorë dhe përpunojë ato në intervale të rregullta.
 - Mblidhen të dhënat e transaksioneve dhe skedarëve kryesorë në një skedar të veçantë.
 - Njoftojnë përdoruesit që të mund të bëjnë rregullime manuale në dalje.
 - Identifikojnë dhe anulojnë hyrjet fiktive për të shmangur kontaminimin e skedarit kryesor.**
44. Ndikimi më i madh që ka pasur teknologjia e informacionit në procesin e auditimit është:
- Përdorimi i tij për të gjurmuar performancën e personelit dhe zhvillimin e stafit të auditimit.
 - Përdorimi i tij në procesin e raportimit të auditimit, të tilla si paketat e automatizuara të letrave të punës.
 - Përdorimi i tij për të kryer auditime duke përdorur teknika të ndryshme të asistuar nga kompjuteri.**
 - Përdorimi i tij si një mjet strategjik për të zhvilluar planin e auditimit.
45. Një auditor i brendshëm u caktua për të konfirmuar nëse personeli operativ kishte korrigjuar disa gabime në dosjet e transaksioneve që u zbuluan gjatë një auditimi të fundit. Cilin nga mjetet e mëposhtme të automatizuara ka më shumë gjasa të përdorë auditori?
- Intervistat në - linjë (online)**
 - Simulimi paralel.
 - Harta.
 - Gjurmimi.
46. Për të identifikuar regjistrimet kontabël të humbura ose jo të plota të shitjeve duke përdorur kompjuterin, qasja më e përshtatshme është:
- Metoda e testimit të të dhënave
 - Simulimi paralel
 - Ri - përpunimi kontrollues**
 - Objektet e testeve të integruara

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

47. Një auditor është duke gjurmuar kartelat individuale të kohës në shpërndarjen e kostos së pagave dhe gjithashtu gjurmon totalët nga shpërndarja e kostos së listës së pagave në llogaritë e ndryshme të punës në proces. Nëse nuk gjenden përjashtime, kjo përbën dëshmi se:
- Në llogaritë e punës në proces nuk janë përfshirë kosto të pambështetura të listës së pagave.
 - Kartelat individuale të kohës janë autorizuar siç duhet.
 - Kostot e listës së pagave janë shpërndarë me saktësi në llogaritë e punës në proces.**
 - Punonjësit janë paguar vetëm për kohën e punuar realisht.
48. Dokumentet e transportit duhet të gjurmohen dhe krahasohen me regjistrimet e shitjeve ose faturat e shitjeve për të:
- Përcaktuar nëse pagesat zbatohen siç duhet në llogaritë e klientëve.
 - Siguruar që dërgesat i'u faturohen klientëve.**
 - Përcaktuar nëse çmimet për njësi të faturuara janë në përputhje me kontratat e shitjes.
 - Konstatuar nëse të gjitha shitjet mbështeten nga dokumentet e transportit.
49. Dëshmia më e besueshme që një auditor mund të vlerësojë kur përcakton titullin ligjor të një kompanie për inventarët është:
- Fitimi bruto mujor dhe nivelet e inventarit.
 - Urdhrat e blerjeve.
 - Faturat e paguara të shitësve.**
 - Regjistrimet e inventarëve të ruajtur në një depo tjetër.
50. Gjatë një hetimi të tkurrjes së pashpjegueshme të inventarit, një auditor i brendshëm po teston shtesat e inventarit siç janë regjistruar në regjistrat e përhershëm të inventarit. Për shkak të dobësive të kontrollit të brendshëm, informacioni i regjistruar në raportet e pranimit të mallit mund të mos jetë i besueshëm. Në këto rrethana, cili nga dokumentet e mëposhtëm do të ofronte dëshminë më të mirë të shtesave në inventar?
- Urdhrat e blerjeve.
 - Kërkesat për blerje.
 - Faturat e shitësve.**
 - Deklaratat e shitësve.